



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.32, datë 29.05.2023

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SUBJEKTIT ZHVILLUES TË OBJEKTIT:
“HOTEL 6 KATE DHE 2 KATE NËNTOKË ME PISHINË “ROYAL 5G”, ME
VENDNDODHJE TEK SHKËMBI I KAVAJËS, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 13, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese Z. Julian Gripshi, Z. Beniamin Kapllani dhe Znj. Valdete Kapllani, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e subjektit zhvillues të objektit: “Hotel 6 kate dhe 2 kate nëntokë me pishinë “Royal 5G”, me vendndodhje tek Shkëmbi i Kavajës, Bashkia Durrës, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.05, datë 30.12.2021, nga Z. Julian Gripshi, Z. Beniamin Kapllani dhe Znj. Valdete Kapllani, në Z. Julian Gripshi dhe “Deivi – 2001” sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

